



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia org. Org.Jedinica Org.Unit	SP-02	№ i Prot. Broj Prot. Prot.No.	1019-2/24
№ i Faqeve Br.Stranica No.Pages	-04-	Data: Datum: Date:	04.04.25
PRISHTINË / A			No.1

DATË/A:	21.02.2025
REFERENC-Ë:	24/1019/MMPHI
PËR/ZA/TO:	N.P.T.T. "Fitimi Comerc" Sh.p.k. Shkozë, Prizren, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, Vërmicë, Prizren.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdimin e Lejes Mjedisore të operatorit, N.P.T.T. "Fitimi Comerc" Sh.p.k. Shkozë, Prizren, me nr. prot. 24/1019/MMPHI, për veprimtarinë: thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, Vërmicë, Prizren.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/1019/MMPHI
Datë: 21.02.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 3 të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit, N.P.T.T. "Fitimi Comerc" Sh.p.k. Shkozë, Prizren, me nr. prot. 24/1019/MMPHI, me nr. prot. 24/6046/MMPHI i ndërpritet procedura administrative për vazhdimin e Lejes Mjedisore, për veprimtarinë: thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, Vërmicë, Prizren, në ngastrën nr.P-71813008-02520-2, zona kadastrale Vërmicë, Prizren.

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, N.P.T.T. "Fitimi Comerc" Sh.p.k. Shkozë, Prizren, për veprimtarinë: thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror, Vërmicë, Prizren, në ngastrën nr. P-71813008-02520-2, zona kadastrale Vërmicë, Prizren, MMPHI konstaton që operatori nuk ka plotësuar kushtet administrative për vazhdim të Lejes Mjedisore.

Faqe 2 nga 4



Kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt.30.09.2022, për përcaktimin e kritereve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Vendimin e Pëlqimit Mjedisor, Nr.17/6181/ZSP/131/19, datë: 15.03.2019;
- Vendimin e Lejes Mjedisore Nr.16/1513/1-ZSP/140/16, datë: 08.07.2016

MMPHI, ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si në vijim:

- Leja për aktivitet të veçantë nga KPMM.

Operatori nuk ka sjell dëshmi për plotësimin e dokumentacionit të cekur me lartë.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **ndërpret procedurën administrative** në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.





Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës - Prizren;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.